

V E N D I M
Nr.550, datë 21.11.1994

**PËR NDRYSHIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË MARRËDHËNIEVE ME BUXHETIN E SHTETIT**

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.137, datë 31.3.1994 “Për disa ndryshime në çmimet e artikujve energjetikë”, në pikën 2, paragrafi i tretë para fundit, ndryshohet si vijon:

“Çmimi i shitjes me shumicë të energjisë elektrike që përdoret nga gjithë konsumatorët (familjarë dhe jofamiljarë), për efekt të ndërtimit të marrëdhënieve me buxhetin e shtetit caktohet 1.4 lekë për çdo kilovat-orë”.

2. Ministria e Financave gjatë vitit 1995 të shikojë mundësinë e rritjes së mëtejshme të çmimit, me synim që të plotësohen nevojat reale të KESH-it për investime.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi